

VENDIM
Nr.25, datë 19.7.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese :

Hilmi Dakli, Anëtar i ""

Veli Budo, Anëtar i ""

Zija Vuci, Anëtar i ""

Alfred Karamuco, Anëtar i ""

Ha1il Kopani, Anëtar i ""

Kristofor Peçi, Anëtar i ""

me sekretare Drita Filto, më datën 11.7.1997 , mori në shqyrtim në seancë gjyqësorë me dyer të hapura çështjen nr .34 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: BASHKIM VELMISHI, kandidat për deputet i pavarur në zonën elektorale nr.82 Patos.

SUBJEKT I INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga sekretari, Z. Thimjo Kondi.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit të datës 5.7.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 4. 2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor" (me ndryshimet).

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi shqyrtoi pretendimet e palëve dhe çështjen në tërësi,

VËREN:

Me procesverbalin datë 30.6.1997, të komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.82 Patos, rezulton se ka fituar kandidati i Partisë Socialiste. Vendimi i komisionit të zgjedhjeve të zonës është lënë në fuqi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Kërkuesi Bashkim Velmishi, kandidat i pavarur, ka kërkuar shfuqizimin e Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke pretenduar se janë falsifikuar dokumentat dhe u janë dhënë subjekteve të tjera votat që ka fituar ai. Por në seancë kërkuesi nuk paraqiti asnjë provë për të vërtetuar pretendimet e tij.

Nga shqyrtimi në tërësi i çështjes, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit është i pabazuar. Për këtë zonë nuk ka asnjë kontestim nga subjektet e tjera dhe votat në favor të kërkuesit janë të papërfillshme.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24 e vijues të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor", njëzëri,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 19.7.1997